



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 3659 Prot.

Tiranë, më 04.08. 2015

UDHËZIM

Nr. 334 Date 04.08.2015

**MBI MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE REALIZIMIT TË DISA
PROCEDURAVE TË PËRQENDRUARA TË PROKURIMIT PUBLIK NË
MINISTRINË E SHËNDETËSISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, te nenit 11 te Ligjit 9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe te pikes 2 , neni 2, Kreu I te VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Per rregullat e prokurimit publik”, me qëllim standartizimin, rritjen e efencës dhe efikasitetit ne perdorimin e fondeve publike,

U D H Ë Z O J :

1. Objekti i udhëzimit është përcaktimi i mënyrës se organizimit dhe realizimit të procedurave te prokurimit publik, qe do te zhvillohen te përqendruara në Ministrinë e Shëndetësisë.
2. Përkufizime:
 - 2.1. Institucionet shendetesore publike për qëllim të këtij udhëzimi, perfshijnë:
 - 2.1.1 “Spitalet publike”
 - 2.1.2 Te gjitha institucionet qe financohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe që janë pergjegjës për realizimin e mbrojtjes shëndetësore sipas kategorive të mëposhtme të buxhetit:
 - Planifikim administrimi
 - Shërbimet e Kujdesit Parësor
 - Shërbimet e Shendetit Publik
 - Shërbimi i Kujdesit Spitalor
 - 2.2. “Organ qëndror bleser”- OQB është autoriteti kontraktor i cili:
 - a.siguron për autoritetet kontraktore mallra dhe/ose sherbime;
 - b.perzgjedh fituesit per kontratat publike për punë, mallra ose shërbime, të caktuara nga autoritetet kontraktore.

2.3 "Autoritet kontraktor" është cdo ent që i nënshtrohen Ligjit të Prokurimit Publik për zbatimin e kontratave të tij publike.

3. Blerja e përqendruar e mallrave dhe shërbimeve të njëjta sipas kategorizimit të mëposhtem, të financuara nga fondet e Ministrisë së Shëndetësisë, i ngarkohet kësaj të fundit e cila vepron si Organ Qendror Blerës në emër të autoriteteve kontraktore të cilat disponojnë fondet përkatëse për :

a) Furnizimin e institucioneve shëndetësore me pajisje mjekësore (aparatura mjekësore, pajisje laboratorike, pajisje dentare etj),

b) Furnizimin e institucioneve shëndetësore me pajisje hotelerie spitalore dhe pajisje mobilimi në përdorim të qendrave shëndetësore.

c) Furnizimin me pajisje mjekësore (kite, reagente, qelqurina etj.) për labororët e Shëndetit Publik, Institutit të Shëndetit Publik dhe Qendrës Kombëtare të Dhurimit dhe Transfuzionit të Gjaku.

d) Shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve komplekse mjekësore spitalore (rezonanca, scanner, angiograf etj)

4. Autoritetet kontraktore, duhet të dergojnë brenda datës 15 Janar të cdo viti, pranë Organit Qendror Blerës, së bashku me rregjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, një kerkese të vecantë të bërë në formë shkresore dhe elektronike, ku të përcaktohen kërkesat për mallrat dhe shërbimet që përfshihen në piken 3 të këtij udhëzimi, emërtimet, sasitë, specifikimet teknike, për cdo artikull, përlllogaritja e fondit limit pa tvsh , si dhe kushtet dhe afatet e lëvrimin të tyre.

4.1 Per raste kur fondet për mallrat që përfshihen në piken 3 të këtij udhëzimi, alokohen gjatë vitit, autoritetet kontraktore, duhet të dergojnë pranë Organit Qendror Blerës, brenda 15 ditëve nga data e alokimit të fondeve , të gjitha të dhenat e cituara në piken 5.

4.2 Autoriteti kontraktor që vë në dispozicion fondet është përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe ndjekjen e saj sipas përcaktimeve në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në fuqi .

5. Lista me emërtimet dhe specifikimet teknike të pajisjeve mjekësore për labororët referuar pikës 3/c të këtij Udhezimi, përgatitet nga grupet e punës të cilet ngrihen me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë. Pas miratimit , lista dërgohet nga drejtoritë përkatëse, prane institucioneve perfituese, të cilët plotësojnë sasitë e detajuara per secilin prej artikujve, mbështetur në nevojat e tyre, duke perlllogaritur dhe fondet e nevojshme .

6. Organi qendror bleres, prokuron fondin limit, të llogaritur si shumë e fondeve, të dërguara dhe miratuara nga çdo autoritet kontraktor.

6.1 Organi qendror blerës shqyrton specifikimet teknike të dërguara nga autoritetet kontraktore sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik në fuqi. Nëse Organi Qendror Bleres gjykon se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik ose se mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, nëpërmjet grupeve të punës të miratuara nga Titullari i Organit Qendror Bler, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre. Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, Organi Qendror Bleres bashkërendon punën me specialistë të fushës të institucioneve përgjegjëse si dhe me specialistë të jashtëm, vendas ose të huaj për unifikimin e specifikimeve teknike në përputhje me standartet.

Listat përmbledhëse të hartuara nga grupet e punës së bashku me fondin limit dhe specifikimet teknike, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, i dergohen Drejtorisë së Prokurimeve dhe Investimeve për shpalljen e procedurave përkatëse.

6.2 Nëse autoritetet kontraktore në percaktimin e të dhenave sasiore kanë marrë për bazë cmimet të ndryshme, për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, Organi Qendror Blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përlogarit të dhënave sasiore sipas fondit të venë në dispozicion.

6.3 Organi Qendror Blerës është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti kontraktor.

Secili prej autoriteteve kontraktore brenda 5 ditëve pas nënshkrimit të kontratës së lidhur është i detyruar të dërgojë pranë Organit Qendror Blerës njoftimin e gjatë dhe të shkurtër të kontratës së lidhur në formë të shkruar dhe elektronike (CD), i cili do të do të hidhet në sistem nga Organi Qendror Blerës.

6.4 Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese.

6.5 Organi qendror blerës mund të kërkojë në çdo fazë të prokurimit, ndihmen e autoritetit kontraktor, si dhe t'i sigurojë ketij të fundit, sa herë që i kërkohet, akses të plotë për çdo informacion për procedurën e prokurimit.

7. Organi Qendror Blerës, merr masat e nevojshme për realizimin e prokurimeve të përqendruara brenda afateve ligjore.

8. Zhvillimi i procedurave të përqendruara të prokurimit publik nga Organi Qendror Blerës dhe lidhja e kontratave nga autoritetet kontraktore bëhet në përputhje me LPP dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

9. Ngarkohen me detyrën e zbatimit të këtij udhëzimi Autoritetet Kontraktore dhe Organi Qendror Blerës në kuptim të këtij udhëzimi.

10. Udhëzimi Nr. 656 date 15.12.2010 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
ILIR BEQAJ

